



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2023

VENDIM

Nr. 8 , datë, 22.02.2023

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.420, DATE 29.09.2022 “PËR LICENCAT DHE
TARIFAT E SHËRBIMIT TË OPERATORËVE UK DERI NË PËRFUNDIM TË
PROCEDURAVE TË RIORGANIZIMIT DHE TRANSFERIMIT TË SHOQËRIVE
UK NË SUBJEKTE ME KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA”**

Në zbatim të neneve 14, germa “e” dhe “i” dhe 19 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, për “Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.302, date 11.05.2022 ”Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, në të cilin edhe ERRU ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Komisioni Kombëtar Rregullator, duke patur në konsideratë periudhën kohore që ju nevojitet njërive të vetëqeverisjes vendore dhe shoqërive UK për përfundimin e procedurave të riorganizimit në Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta (SKP-UK) si edhe aplikimin për tarifa të reja sipas Vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr.539, datë 30.12.2021 "Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”,:

VENDOSI:

Pas pikës 3 të vendimit Nr.420, datë 29.09.2022, shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

Shoqëritë SKP-UK gjatë periudhës tranzitore, për zonat e shërbimit që janë bërë pjesë e tyre, të cilat nuk kanë pasur tarifa të miratuara nga ERRU për shërbimet UK të ofruara ndaj konsumatorëve, do të përdorin tarifën aktuale me të cilat janë faturuar konsumatorët e këtyre zonave të shërbimit përpara reformës deri në miratimin e tyre nga Komisioni Kombëtar Rregullator. Gjithashtu zonat e bardha (pa shërbim) dhe pa infrastrukturë inxhinierike të cilat nuk kanë qenë të shërbyera më parë nga shoqëritë UK ekzistuese, por ndërkohë janë plotësuar me infrastrukturë inxhinierike për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, do të konsiderohen si pjesë e zonës së shërbimit dhe do të aplikohen tarifën e shoqërive UK ekzistuese sipas bashkive përkatëse deri në miratimin e tyre nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha shoqëritë UK dhe SKP-UK si dhe të gjitha strukturat e ERRU.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ndriçim Shani